



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimi / Dateduar Primeni / Datedo Received / Datedo	12.01.2024	14	115
Organi / Sh. shtet. / Organ / Sh. shtet. / Org. Unit	Ri. Prof. Ri. Prof. Prof. No.	Shtesa e Futur / Appendix	Sasia Kufizuar / Quantity
SKUMBATI	248/2024		115



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.1395/2023**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave** në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1395/2023, të datës 08.11.2023, të parashtruar nga ankuesit \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ të cilët me autorizim i përfaqëson ankuesi \_\_\_\_\_ me adresë: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ kundër Raportit të Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike i miratuar sipas Vendimit Nr.23/165 të datës 12.10.2023 të Qeverisë së Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 11.01.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

**Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1395/2023 e datës 08.11.2023, e parashtruar nga ankuesit \_\_\_\_\_**

**A r s y e t i m**

Ankuesit \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ të punësuar në Ministrinë e Rinisë, Kulturës dhe Sportit, me datë 08.11.2023 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, e cila është regjistruar nën shenjën A.nr.1395/2023, kundër Raportit të Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike i miratuar sipas Vendimit Nr.23/165 të datës 12.10.2023 të Qeverisë së Kosovës, lidhur me aprovimin e listës së eksperteve sipas shtojcës 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, trajtimit jo të barabartë me pozitave ekuivalente të institucioneve të tjera, shkeljeve procedurale dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale gjegjësisht Rregullores Nr.11/2023 për Ekspertët.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej vetëm Këshilli*), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 17.11.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komisionin për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, ndërsa, ky i fundit, me datë 29.11.2023, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me provat materiale lidhur me këtë çështje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me qëllim të shqyrtimit të kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën e datës 08.11.2023 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 08.11.2023 të përcjellë nga ankuesit në Këshill; Autorizimin e datës 07.11.2023; Shkresën e datës 22.12.2020; Shkresën e datës 27.04.2023; Shkresën e datës 29.12.2021; Shkresën e datës 11.11.2020; Shkresën e datës 24.11.2020; Shkresën e datës 10.10.2023; E-mailin e datës 27.10.2023 dërguar nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ E-mailin e datës 19.10.2023 dërguar nga Komisioni për ankuesin \_\_\_\_\_ me korrespondencën e bashkangjitur; Kërkesën e datës 24.03.2023; Kërkesën e datës 24.10.2023; Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 12.10.2023 me Raportin e Punës së Komisionit; Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 08.03.2023; Pyetësorët për identifikimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike në MKRS; Vendimin e datës 18.06.2014; Akt emërimin e datës 23.10.2012 me përshkrimin e detyrave të punës; Akt emërimin e datës 03.06.2014 me përshkrimin e detyrave të punës; Përshkrim i detyrave të punës i datës 14.03.2019; Akt emërimin e datës 19.05.2020; Akt emërimin e datës 06.09.2012; Shpallje e datës 13.04.2011; Shkresë e datës 03.07.2011 më shifër:2460; Vendimin e datës 02.05.2012; Vendimin e datës 05.04.2012; Shkresë e datës 10.02.2012 me shifër:3047; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 17.11.2023; Përgjigje në kërkesë e datës 29.11.2023; E-mail i datës 29.11.2023 dërguar nga Komisioni për Këshillin; Procesverbalin e datës 19.04.2023; Shkresën e datës 14.11.2023 dërguar nga ankuesit në Këshill për plotësim e ankesës së datës 08.11.2023; Akt emërimin e datës 25.07.2014 me përshkrimin e detyrave të punës; Vendimin e datës 18.06.2014; Përshkrimin e detyrave të punës e datës 26.03.2014; Përshkrim i detyrave të punës i datës 14.03.2019; Akt emërimin e datës 19.05.2020; Akt emërimin e datës 06.09.2012; Vendimin e datës 05.04.2012.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit është e **pabazuar**, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se ankuesit janë të punësuar në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, gjegjësisht ankuesi \_\_\_\_\_ sipas vendimit të datës 18.06.2014 mban pozitën e punës "Udhëheqës i Divizionit të Teknologjisë Informative dhe Shërbimeve Logjistike", ankuesi \_\_\_\_\_ sipas Aktit të emërimit të datës 03.06.2014 mban pozitën e punës "Zyrtar i Lartë për Teknologji Informative", ankuesi \_\_\_\_\_ sipas Aktit të emërimit të datës 19.05.2020 mban pozitën e punës "Zyrtar për Administrimin e Teknologjisë Informative", ankuesi \_\_\_\_\_ sipas Aktit të emërimit të datës 06.09.2012 mban pozitën e punës "Administrator i databazës" dhe ankuesi \_\_\_\_\_ sipas Aktit të emërimit të datës 25.07.2016 mban pozitën e punës "Zyrtar i IT-së" në kuadër të Divizionit të Teknologjisë Informative dhe Shërbimeve Logjistike.

Tutje nga shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur së Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin Nr.07/132 të datës 08.03.2023, ka themeluar Komisionin për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave të dërguara nga institucionet që kanë të bëjnë me sistemin shtetërore të informacionit dhe komunikimit

më rëndësi strategjike sipas Rregullores Nr.11/2023 për Ekspertët dhe dërgimin në Qeveri, të listës së Eksperteve, të kategorizuar në shtojcën 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike, ka përgatit Raportin e punës, listën e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimeve me rëndësi strategjike dhe listën e pozitave të eksperteve sipas shtojcës 14.4 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, të cilat janë miratuar nga Qeveria e Kosovës, me Vendimin Nr.23/165 të datës 12.10.2023.

Nga vlerësimi i Raportit të punës lidhur me përcaktimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimeve me rëndësi strategjike, Kolegji i Këshillit konstatoi se asnjëri nga sistemet e prezantuara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve përmes shkresë së datës 24.03.2023 sikurse 1. *Sistemi për Menaxhimin e Detyrave/Kërkesave*, 2. *Menaxhimi i Granteve për Ministrinë*, 3. *Databaza e Trashëgimisë Kulturore*, 4. *Platforma për Menaxhimin Operacional të Financave dhe* 5. *Platforma Komunikuese e MKRS-së*, nuk rezultojnë të jenë klasifikuar si sisteme shtetërore të informacionit dhe komunikimeve me rëndësi strategjike nga ana e Komisionit përkatës.

Në kuptim të shqyrtim të pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 11/2023 për Ekspertët, më të cilën janë përcaktuar rregullat dhe procedura për zbatim të shtojcës 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik me theks të veçantë:

- **Nenin 3**, më të cilin është përcaktuar se: 1. *Shprehjet e përdorura kanë këtë kuptim: 1.1. sistemet shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike - nënkupton sistemet që plotësojnë së paku njërin nga kriteret në vijim: 1.1.1. infrastruktura kritike e informacionit (IKI), që përfshinë sistemet ose funksionet, paaftësimi ose shkatërrimi i të cilave do të mund të cenonte sigurinë kombëtare, qeverisjen, ekonominë ose mirëqenien sociale të vendit; 1.1.2. sistemet përmes të cilave qeveria realizon funksionet e saj themelore (sistemet e tatimeve, doganave, thesarit, buxhetit, prokurimit publik, shëndetësisë, mirëqenies sociale, arsimit, sigurisë, gjykatave, prokurorisë, sigurisë kibernetike, mbrojtjes, etj); 1.1.3. regjistrat kyç shtetëror (regjistri civil, regjistrat kadastral, regjistri i bizneseve, regjistri i OJQ-ve, regjistri i lëndëve gjyqësore, regjistri i adresave, regjistri i automjeteve, etj.); 1.1.4. sistemet të cilat lidhen me menaxhimin e proceseve në administratën publike (sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore; sistemin për menaxhimin e financave, sistemi i postës elektronike zyrtare shtetërore, sistemi për menaxhimin e pasurisë shtetërore, etj.). 1.1.5. sistemet qendrore të Qeverisjes (Platforma e interoperabilitetit, Portali qendror për shërbime ndaj qytetarëve dhe bizneseve, Sistemi i identifikimit dhe nënshkrimit elektronik); 1.1.6. qendrat shtetërore të të dhënave; 1.1.7. rrjeti qeveritar; 1.1.8. sistemet e sigurisë që mundësojnë sigurinë kibernetike, sigurinë e rrjetit qeveritar, të dhënave dhe të qasjes në sisteme kompjuterike.*

- **Nenin 4:** *Institucioni i cili vlerëson se posedon, menaxhon ose koordinon funksionimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike e që plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë rregullore, duhet të bëjnë kërkesë tek Komisioni, sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje. 2. Kërkesa e Institucionit për konsiderimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike shtetërore duhet të përmbajë: 2.1. informacionin për nivelin e klasifikimit të sistemeve përkatëse të rrjetit dhe informacionit; 2.2. kategorinë e shërbimeve që ofrojnë sistemet përkatëse të rrjetit dhe informacionit; 2.3. përshkrimin e të dhënave që përmbajnë sistemet përkatëse; 2.4. ndikimin e sistemeve përkatëse të rrjetit dhe informacionit në realizimin e objektivave të institucioneve shtetërore; 2.5. ndikimin e sistemeve përkatëse të rrjetit dhe informacionit në realizimin e obligimeve ligjore të institucioneve kërkues dhe institucioneve tjera shtetërore; 2.6. ndikimin e sistemeve përkatëse të rrjetit dhe informacionit në realizimin e shërbimeve esenciale siç janë: shërbimet publike, shëndetësia, siguria, drejtësia, arsini dhe mbrojtja; 2.7. rrezikun për sisteme përkatëse të rrjetit dhe informacionit*

nga sulmet kibernetike të brendshme apo të jashtme; 2.8. funksionet menaxhuese/koordinuese dhe shkallën e njohurive të specializuara që kërkohen për menaxhimin, koordinimin, zhvillimin, administrimin, mirëmbajtjen dhe avansimin e sistemeve përkatëse të rrjetit dhe informacionit; 2.9. periudhën kohore të përcaktuar që sistemet përkatëse të rrjetit dhe informacionit mund të mbeten jashtë funksionit; 2.10. sa është unik në nivel shtetëror secili sistemi përkatës i rrjetit dhe informacionit dhe a ofrohen shërbime të ngjashme edhe nga sisteme të tjera të rrjetit dhe informacionit nga institucione tjera shtetërore; 2.11. përshkrimin e informacioneve të tjera të rëndësishme për sistemet përkatëse të rrjetit dhe informacionit që nuk janë përshkruar më lartë dhe që e bëjnë të nevojshme vlerësimin e këtyre sistemeve të rrjetit dhe informacionit si sisteme shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike shtetërore; 2.12. datën e futjes në funksion të sistemeve përkatëse të informacionit dhe komunikimit; 2.13. emërtimin e pozitave kyçe që janë përgjegjëse për dizajnimin, menaxhimin, koordinimin, zhvillimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve përkatëse të informacionit dhe komunikimit, dhe propozimin për kategorizim të tyre sipas klasave të përcaktuara në shtojcën 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik. 3. Kategorizimi i sistemeve në bazë të shërbimeve që ofron sipas paragrafit 2, nën paragrafit 2.2 të këtij neni ndahet si më poshtë: 3.1. shërbime për qytetarë 3.2. shërbimet për shëndetësi; 3.3. shërbime për financa / prokurim; 3.4. shërbime për siguri dhe mbrojtje; 3.5. shërbime për arsim; 3.6. shërbime për drejtësi; 3.7. shërbime interne për administratë publike. 4. Kërkesa e aprovuar nga Zyrtari më i lartë administrativ i institucionit, dërgohet tek komisioni qeveritar për vlerësim të sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike.

**-Nenin 5:** Kriteret për caktimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike. Sistemet do të vlerësohen si sisteme shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike nëse plotësojnë të paktën një prej kritereve të përcaktuara në përkufizimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike në paragrafin 1.1 të nenit 3 të kësaj Rregulloreje....”

Po ashtu për vendosje të drejtë lidhur me këtë çështje administrative, Kolegji i Këshillit iu referua detyrave dhe përgjegjësisë të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të publikuara në faqen zyrtare <https://ëëë.mkrs-ks.org/?page=1,185>: “Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (në tekstin e mëtejshëm: MKRS) ka përgjegjësi të mëtejshme si në vijim: 1. Përgatitjen e politikave publike, hartimin e akteve ligjore, hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore dhe përcaktimin e standardeve të detyrueshme në fushën e kulturës, rinisë, sportit, të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta; 2. Zbaton planet e veprimit dhe legjislacionin për të përkrahur fushën e kulturës, duke përfshirë programet e institucioneve të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore për mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, avancimin e lidhjeve kulturore dhe shkëmbimeve ndërkulturore të artistëve, shoqatave kulturore dhe institucioneve të kulturës; 3. Zbaton planet e veprimit dhe legjislacionin për të përkrahur fushën e rinisë, organizatat rinore, klubet, qendrat rinore dhe organizatat e përfaqësimit, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes në vendim marrje dhe në jetën publike, pjesëmarrjen në edukimin jo formal, në punësueshmëri, edukim dhe promovim shëndetësor, si dhe në kulturë, sport dhe rekreacion; 4. Zbaton planet e veprimit dhe legjislacionin për të përkrahur funksionimin e aktiviteteve dhe infrastrukturës në sport, duke përfshirë programet për mbështetjen e sportistëve, specialistëve të sportit, klubeve dhe federatave në ngritje të përfshirjes, cilësisë dhe pjesëmarrjes në aktivitete dhe gara sportive në vend dhe ato ndërkombëtare; 5. Zbaton planet e veprimit dhe legjislacionin për të përkrahur fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, duke përfshirë programet për mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, avancimin e legjislacionit përkatës dhe licencimin e Shoqatave për Administrim Kolektiv të të Drejtave; 6. Harton programe për ngritjen e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve kulturore, rinore dhe sportive dhe ndihmon në vendosjen e kontakteve, shkëmbimin e informatave dhe përvojave më të mira; 7. Harton programe për ngritjen e nivelit të komunikimit kulturor dhe bashkëjetesës mes kulturave të të gjitha komuniteteve etnike, fetare apo gjuhësore në vend, duke përfshirë edhe promovimin kulturor dhe bashkëpunimin në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit jashtë vendit; 8. Kryen edhe detyra të tjera që i caktohen ministrisë me legjislacionin përkatës në fuqi” dhe ka ardhur në përfundimin se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit,

gjegjësisht sistemet e tyre të prezantuara si në shkresën e datës 24.03.2023 pranë Komisionin për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike, nuk përmbajnë apo nuk plotësojnë parakushtet e përcaktuara si në dispozitat e nenin 3 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2023 për Ekspertët, gjegjësisht të njëjtat nuk hyjnë në kuadër të sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike sikurse përcaktohet edhe me nenin 5 të së njëjtës rregullore.

Prandaj nga se u tha si më lart në konstatimet e dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, ankesa e ankuesve e datës 08.11.2023 e parashtruar në Këshill është e pabazuar për shkakun se, sistemet e prezantuara pranë Komisionit apo të cilat MKRS i shfrytëzon me qëllim të përmbushjes së funksioneve dhe mandatit ligjor nuk janë sisteme që mund të përfshihen në kuadër të sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike sikurse përcaktohet me nenin 5 ndërlidhur me 3 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2023 për Ekspertët, e për rrjedhojë ankuesit nuk mund të përfshihen në kuadër të shtojcës 14.4 për Ekspertët Ligjit Nr.08/L-198 për pagat e Zyrtarëve Publik, ngase sipas nenit 6 paragrafi 5 të së njëjtës rregullore, parakusht ligjor është që fillimisht institucioni punëdhënës i ankuesve në këtë rast, gjegjësisht sistemet me të cilat operon apo përmbush funksionin sipas qëllimit të themelimit duhet të bëjnë pjesë në kuadër sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike, e që në rastin konkret sistemet e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit nuk hyjnë në këtë grup.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi sikurse në dispozitivin e këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.1395/2023

**Flakron GASHI**

*Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional*



**Vendimi i dorëzohet:**

- Përfaqësuesit të ankuesve, ankuesit
- Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike/Qeveria e Kosovës;
- Njësisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.